



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:267984

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876251

KPPP.nr.2076/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit “Telekomi i Kosovës” SH.A, me seli në Prishtinë, me NUI: 811288001, kundër debitorit “KK Mitrovicë”, Nr.L.NJ: 90000900, me adresë “Tunel i Parë” pn, në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Lirim Zeka, me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.372/23 të datës 03.11.2023 të Përmbaresit Privat Fazli Gjonbalaj, me seli të zyrës në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 20.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “KK Mitrovicë”, ANULOHET urdhri përmbare P.nr.372/23 i datës 03.11.2023, i Përmbaresit Privat Fazli Gjonbalaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbare.

**A r s y e t i m**

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Telekomi i Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbare P.nr.372/23 të datës 03.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.550025955/2151 të datës 06.01.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 290.32 Euro, me kamatëvonesë prej 8%, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të

gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogari të veçantë bankare të Përbaruesit Privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përbarimore të zbatojë përbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se fatura në bazë të së cilës është inicuar procedura përbarimore nuk është e përshtatshme për përbarim, ngase e njëjta nuk është e pranuar në mënyrë të rregullt dhe si e tillë nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Fatura për të qenë e përshtatshme për përbarim duhet të nënshkruhet dhe të vuloset nga personi kompetent për t'i pranuar faturat, andaj në rastin konkret fare lehtë mund të vërtetohet se kjo faturë është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përbarim si dhe të obligohet kreditori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se të gjitha faturat e papaguara si në propozimin për përbarim (muajve 05-12/2021), dhe urdhri përbarimor P.nr.373/23, debitorit i janë dorëzuar përmes postës elektronike, dhe atë sipas vet kërkesës së debitorit. Më tutje ka theksuar se debitori asnjëherë nuk i ka kontestuar faturat, dhe se pretendimet e tij janë të pa bazuara. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të vazhdohet me përbarimin e urdhrin përbarimor P.nr.372/23 të datës 03.11.2023, konform dispozitave të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet dhe procedura përbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret - Fatura Nr.550025955/2151 e datës 06.01.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se kjo faturë në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se fatura në rastin konkret i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes postës elektronike, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se nuk është provuar në asnjë mënyrë se debitori faturën e lartcekur e ka pranuar me postë elektronike.

Andaj duke qenë se nuk ka prova se debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, rezulton se fatura e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi

Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2076/23, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.